

Luani me shkronja dhe numra

Ka shumë lloje lojërash me shkronja dhe numra që mund të luani, që nga forma e tingulli i tyre deri te mësimi i fjalëve të reja që e kanë të njëjtë shkronjën e parë. Mund të mendoni për numra që fëmija juaj i njeh, si numri i derës ose mosha e tyre, dhe të shihni nëse mund t'i gjeni këta numra në autobusë, dyqane ose tabela rrugore. Kini parasysh se shkronjat dhe numrat gjenden kudo!

Këshillë me yll

Numëroni me zë bashkë me fëmijën – gjeni sa hapa ju duhen për të arritur te dera ose sa shtylla dritash kaloni derisa të arrini te parku!

Ide të vogla për biseda

Flisni për shkronjat që mund të gjeni te letrat e parëndësishme dhe te revistat e vjetra. Pritni shkronjat dhe bëni një kolazh. Shikoni nëse mund të gjeni shkronjën e parë të emrit të fëmijës. Nëse nuk ai e gjen dot shkronjën akoma, vizatoheni së bashku dhe shikoni nëse ai mund ta gjejë kur të dilni jashtë.



"Do të shkoj në park"

Luani një lojë duke thënë me radhë se çfarë do të merrni me vete kur të shkoni në park. Rregulli është se mund të merrni me vete vetëm gjërat që fillojnë me tingullin "p" (për shembull, "Do të shkoj në park dhe do të marr një pemë/patate/pulë picnic/parrot/pencil"). Mund të argëtoheni më shumë duke e ndryshuar vendin ku po shkoni (për shembull, në bregdet, ku mund të merrni me vete vetëm gjëra që fillojnë me "s"). A mund të mbani mend çdo gjë që do të merrni me vete?

Shkronja me plastelinë ose brumë

Provoni të krijoni së bashku shkronja duke përdorur plastelinë, ose bëni pak brumë.

Bashkoni:

- dy gota miell
- ½ ujë të ftohtë
- tre lugë gjelle vaji vegjetal
- një lugë gjelle lëngu limoni (opsional)
- ngjyrues ushqimi ose xixa sipas dëshirës.

Ide të vogla për biseda

Për ta nxitur fëmijën që të mësojë të lexojë, përdorni tingujt e shkronjave në vend se emrat e shkronjave në alfabet. Përdorimi i tingujve të shkronjave kur luani së bashku lojëra, si "Do të shkoj në park" ose Unë spiunoj, do t'i ndihmojë të thotë tingujt e fjalëve ndërsa mëson për të lexuar.

